2181 -MOBILJE DHE ORENDI 22,406,108

MAGAZINA QENDRORE

Karrige jeshile te larta foam	COP	49.00	32,899	1,612,064
Karrige orange te ulfa	COP	10.00	23,973	239,731

ZYRAT

Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	10.00	28,500	285,000
Tavoline zyre me strukture HPL ne forme L me komordine	COP	6.00	48,000	288,000
Tavoline per mbledhje me strukture metalike	COP	1.00	30,000	30,000
Dollape me kanate per ke zyra e drejtorit	COP	1.00	27,600	27,600
Kuzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine dhe aksesore blun	ML	2.50	40,000	100,000
Banko 2 cm per veshje muri tek kuzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope+shesh	COP	1.00	9,000	9,000
Tavoline HPL per tek guzhina	COP	1.00	27,600	27,600

Handwritten signature

Handwritten signature

Dyer te brendshme	COP	7.00	24,000	168,000
1526/15824 Karrige me lartesi te regullueshme	COP	4.00	38,291	153,163
1662/15824 Karrige me e vogel me lartesi te regullueshme	COP	21.00	32,877	690,419
LABORATORI QSUT				
Dollape per garderoben per 4 persona +dorezat	COP	25.00	22,008	550,200
Strukture metalike tavoline +montim suprin 90*90*90	COP	2.00	18,000	36,000
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	8.00	28,500	228,000
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	11.00	23,500	258,500
Tavoline me syprine HPL +str metalike 150*85*75	COP	4.00	25,500	102,000
Tavoline me syprine HPL +str metalike 150*70*75	COP	2.00	25,500	51,000
Strukture metalike +hpl +montim 156*65*90	COP	4.00	18,000	72,000
Strukture metalike +hpl +montim 150*65*90	COP	1.00	18,000	18,000
Strukture metalike +hpl+montim 131*65*90	COP	1.00	18,000	18,000
Tavoline me syprine hpl 180*70*75	COP	1.00	25,500	25,500
tavoline me syprine e strukt metal 180*70*75	COP	4.00	25,500	102,000
Mini dollap me strukture e kapak hpl 80*70*35	COP	3.00	11,000	33,000
Etazher me strukture tek dhoma emj 80*40*25	COP	5.00	3,500	17,500
Karrige jeshile te larta	COP	23.00	32,899	756,684
Karrige jeshile te larta foam	COP	15.00	32,899	493,489
Karrige orange te ulta	COP	25.00	23,973	599,328
Rafte metalike -6004-0185	COP	1.00	39,301	39,301
Tavoline me syprine +str metalike per pergje e anal 110*60*75	COP	1.00	22,002	22,002
Dollap ku vihen sirtaret past mestr HPL e kapak HPL	COP	1.00	22,002	22,002
Kembaleca +dysheme druri tek mikrobiologjia	COP	3.00	6,000	18,000
Laminat per syprina laboratorit -Max Compact Resistance)	COP	34.00	33,204	1,128,930
Tavoline me syprine HPL +strukt metalike 150*60*75	COP	4.00	25,500	102,000
Syprine tavoline 2		8.00	28,116	224,931
RACK19,42he 800*1000*2033 zeze xokel dyer grille	COP	1.00	93,312	93,312
Karrige me lartesi te regullueshme 16G2/15824	COP	5.00	32,859	164,293
Karrige me lartesi te regullueshme 152G/15824 38279	COP	1.00	38,269	38,269
COVID 4 (DEGE E QSUT)				
Karrige jeshile te larta foam	COP	2.00	32,899	65,799
Karrige orange te ulta	COP	2.00	23,973	47,946
LABORATORI TRAUMA-USHTARAK				
Strukture metalike tavoline +montim suprin 90*90*90	COP	2.00	18,000	36,000
Tavoline me syprine HPL +strukt metalike ke dhoma mjekeve 150*70	COP	4.00	25,500	102,000
Dollape per garderoben per 4 persona +dorezat	COP	6.00	22,800	136,800
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	3.00	28,500	85,500
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	18.00	23,500	423,000
Dollape pa kanata me strukt melamine 215*210	COP	1.00	33,000	33,000
Strukture metalike +hpl +montim syprine 150*70*90	COP	4.00	18,000	72,000
Strukture metalike per tavoline +hpl+montim 104*70*90	COP	3.00	18,000	54,000
Strukture metalike per tavoline +HPL+montim 134*70*90	COP	6.00	18,000	108,000
Karrige jeshile te larta foam	COP	8.00	32,899	263,194
Karrige orange te ulta	COP	3.00	23,973	71,919
Guzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine	ML	3.30	40,000	132,000
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	9,004	9,004
Syprine tavoline 2	COP	15.00	28,116	421,746
MATERNITETI I VJETER				
Dollape per garderoben per 4 persona +dorezat	COP	5.00	22,800	114,000
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	1.00	28,500	28,500
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	17.00	23,500	399,500
Tavoline me syprine HPL +str metalike 150*70*75	COP	2.00	25,500	51,000
Strukture metalike per tavoline +hpl multistrat +montim syprine 130*70	COP	2.00	18,000	36,000
Strukture metalike per tavol +hpl+montim 90*90*85	COP	3.00	18,000	54,000
Strukture metalike per tav te lyer +hpl+montim syprine 120*70*85	COP	4.00	18,000	72,000
Dollape me 2 kanata xham	COP	2.00	21,500	43,000
Strukture metalike per tavoline+Hpl +montim syprine HPL 140*70*85	COP	2.00	18,000	36,000
Tavoline me syprine hpl per tek receptioni 150*60*75	COP	2.00	25,500	51,000
Tavoline me syprine hpl tek receptioni 130*60*75	COP	2.00	25,500	51,000
Karrige jeshile te larta foam	COP	8.00	32,899	263,194
Karrige orange te ulta	COP	3.00	23,973	71,919
Guzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine	ML	2.35	40,000	94,000
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	9,000	9,000
Syprine hpl 3.6 me kende inoksi per coffe area	COP	1.00	16,500	16,500
Syprine tavoline 1	COP	11.00	22,981	252,789
MATERNITETI I RI				
Strukture metalike per tavoline +montim HPL 153*70*80	COP	5.00	18,000	90,000
Strukture metalike tavoline +montim suprin 90*90*90	COP	2.00	18,000	36,000
Strukture metalike tavoline+montim sypr 140*70*80	COP	4.00	18,000	72,000

Algeria

[Signature]

Tavoline me syprine HPL kronosparn +strukt metalike ke dhoma mjekes	COP	3.00	25,500	76,500
tavoline me syprine HPL +strukt metalike 150*60*75	COP	1.00	25,500	25,500
Dollape per garderooben per 4 persona +dorezat	COP	6.00	22,800	136,800
Guzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine	ML	2.40	40,000	96,000
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	9,000	9,000
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	3.00	28,500	85,500
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	15.00	23,500	352,504
Syprine tavoline 2	COP	11.00	28,118	309,280
SHEFQET NDROQI-SANATORIUM				
Guzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine	ML	2.40	40,000	96,000
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	9,000	9,000
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	25.00	23,500	587,500
Strukture metalike tavoline +montim HPL 123*70*80	COP	4.00	18,000	72,000
Strukture metalike tavoline +montim HPL 163*70*80	COP	5.00	18,000	90,000
Strukture metalike tavoline+montim 90*90*80	COP	3.00	18,000	54,000
Strukture metalike tavoline+montim HPL 136*70*80	COP	7.00	18,000	126,000
Tavoline me syprine HPL +str metalike 150*65*75	COP	2.00	25,500	51,000
tavoline me syprine HPL +str metalike 150*70*75	COP	2.00	25,500	51,000
Tavoline me syprine HPL+strukt metal 120*60*75	COP	1.00	25,500	25,500
Mini dollap me strukt HPL e kapak xhami 115*70*30	COP	1.00	15,000	15,000
Dollape me 4 kanate	COP	4.00	28,500	114,000
Dollape per garderooben per 4 persons	COP	6.00	22,800	136,800
Strukture metalike +hpl multistrat +montim suprine hpl 190*70*80	COP	1.00	18,000	18,000
Karrige jeshile te larta foam		6.00	32,899	197,396
Karrige orange te ulta		5.00	23,973	119,866
Syprine tavoline 2	COP	19.00	28,117	534,214
SPITALI DURRES				
Strukture metalike tavoline +montim suprin 90*90*90	COP	2.00	18,000	36,000
Tavoline me syprine HPL +strukt metalike 150*60*75	COP	5.00	25,500	127,500
Dollape per garderooben per 4 persona +dorezat	COP	6.00	22,800	136,800
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	13,800	13,800
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	3.00	28,500	85,500
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	18.00	23,500	423,000
Strukture metalike per tavoline +hpl multistrat +montim syprine 130*70	COP	3.00	18,000	54,000
Kuzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine dhe aksesore blum	ML	2.40	40,000	96,000
Strukture metalike per tavoline+hpl multistrat mbulim tavoline+montim	COP	10.00	18,000	180,000
Syprine tavoline 1	COP	14.00	22,981	321,731
SPITALI BERAT				
Strukture metalike tavoline +montim suprin 90*90*90	COP	2.00	19,200	38,400
Tavoline me syprine HPL +strukt metalike 150*60*75	COP	3.00	25,500	76,500
Dollape per garderooben per 4 persona +dorezat	COP	5.00	24,000	120,000
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	10,200	10,200
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	5.00	28,500	142,500
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	12.00	23,837	286,040
Dollap per garderooben ne zyren e mjekëve per 1 person+dorezat	COP	3.00	12,000	36,000
Kuzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine dhe aksesore blum	ML	3.35	40,000	134,000
Strukture metalike +hpl + montim syprine 175*70*90	COP	6.00	19,200	115,200
Strukture metalike +hpl multistrat+montim syprine HPL 220*70*90	COP	1.00	19,200	19,200
Syprine tavoline 2	COP	9.00	28,117	253,049
SPITALI LEZHE				
Strukture metalike tavoline +montim suprin 90*90*90	COP	3.00	18,000	54,000
Tavoline me syprine HPL +strukt metalike 150*60*75	COP	4.00	25,500	102,000
Dollape per garderooben per 4 persona +dorezat	COP	4.00	22,800	91,200
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	9,000	9,000
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	3.00	28,500	85,500
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	16.00	25,000	400,000
Strukture metalike per tavoline +hpl multistrat +montim syprine 130*70	COP	9.00	18,000	162,000
Kuzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine dhe aksesore blum	ML	2.20	40,000	88,000
SPITALI LUSHNJE				
Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,400	14,400
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	1.00	27,600	27,600
Dollape me 4 kanate	COP	4.00	36,000	144,000
Tavoline zyre me strukture HPL ne forme L me komodine	COP	2.00	48,000	96,000
Tavoline per mbledhje me strukture metalike	COP	1.00	84,000	84,000
Kuzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine dhe aksesore blum	ML	5.50	40,036	220,200
Lavapjat inoks 1+1 grope+shesh	COP	1.00	10,800	10,800
Tavoline me syprine HPL +strukt metalike 150*60*75	COP	3.00	25,500	76,500

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Banko 2 cm per veshje muri tek guzhina	COP	1.00	14,000	14,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	9,000	9,000
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	12.00	24,900	298,800
Dollape me 4 kanate	COP	3.00	28,500	85,500
Dollape per garderoben per 4 persons	COP	4.00	22,800	91,200
Strukture metalike per tav te lyer +hpl+montim syprine 120*70*85	COP	2.00	18,000	36,000
Strukture metalike +hpl +montim syprine 150*70*90	COP	7.00	18,000	126,000
Kuzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine dhe aksesore blun	ML	2.10	40,000	84,000
SPITALI FIER				
Strukture metalike per tavoline +montim HPL 153*70*80	COP	1.00	18,000	18,000
Strukture metalike tavoline +montim suprin 90*90*90	COP	2.00	18,000	36,000
Lavapjat inoks 1+1 grope +shesh	COP	1.00	9,000	9,000
Dollape me 4 kanate 2 me xham+2 me hpl	COP	3.00	28,500	85,500
Komedina me strukture dhe kapak HPL me aksesore blum+rrota me s	COP	17.00	24,912	423,500
Dollape per garderoben per 4 persons	COP	5.00	22,800	114,000
Strukture metalike +hpl multistrat +montim suprine hpl 190*70*80	COP	1.00	18,000	18,000
Strukture metalike +hpl multistrat +montim suprine hpl 190*70*80	COP	1.00	18,000	18,000
Tavoline me syprine hpl per tek receptioni 150*60*75	COP	2.00	25,500	51,000
Strukture metalike +hpl +montim 150*65*90	COP	8.00	18,000	144,000
Tavoline per mbledhje me strukture metalike	COP	1.00	25,500	25,500
Kuzhina me kapak HPL 1.8 me strukture melamine dhe aksesore blun	ML	2.15	40,000	86,000
Banko 2 cm per veshje muri tek kuzhina	COP	1.00	14,000	14,000
				115,000
215 -MJETE TRANSPORTI				115,000
Motorcikle	COP	1.00	115,000	115,000

TOTALI	249,239,302
---------------	--------------------


HARTUESI

Adriana Zagovic

Adriana Zagovic

ADMINISTRATOR

SOKOL RAMIZI



1. Informacione të përgjithshme

LABORATORY NETWORKS sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe gjendet e rregjistruar në rregjistrin tregtar (QKB), indentifikuar me NIPT-in L91923002T . Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nga statuti i saj.

Adresa e selisë së shoqërisë është Rruga Siri Kodra, tek ish frigoriferi, Nr. 149, Tiranë.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për ushtrimin 2020 ka qene :

Aktiviteti Ekonomik i Shoqërisë lidhet dhe është në funksion të implementimit dhe zbatimit të PPP/Marreveshjes së Koncesionit që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë në Republikën e Shqipërisë ("Autoriteti Kontraktues" apo "MESH") dhe Shoqërisë për Ofrimin e Shërbimeve Diagnostikuese nga Laboratorët Mjekësorë në Spitalet Universitare, Rajonale dhe të Bashkive të Sarandës dhe Lushnjës ("Marreveshja e Koncesionit") përfshirë ofrimin dhe prokurimin e çdo dhe të gjithë shërbimeve dhe mallrave të lidhura si edhe kryerjen e çdo aktivitetit tjetër për këtë qëllim ("Projekti"). Në përputhje me Legjislacionin Shqiptar për permbushjen e objektivit të sipërmendur, Shoqëria mund (i) të kryejë çdo aktivitet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për permbushjen e objektivit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër; (ii) të blejë, në mënyrë të drejtperdrejte apo të terthorte, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj; dhe (iii) të kryejë aktivitete publikimi e reklamimi; (iv) të kryejë aktivitete import-eksporti; (v) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për permbushjen e objektivit të Shoqërisë.


Kapitali rregjistruar aktualisht është 10,000,000 ALL dhe zotërohet nga :

1. LABOPHARMA SHPK Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 41.7% të pjesëve të Kapitalit - Para: 4.170.000,00 leke.
2. AB Laboratory Solutions B.V Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 33.3% të pjesëve të Kapitalit - Para: 3.330.000,00 leke.
3. EXALAB Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 25% të pjesëve të Kapitalit - Para: 2.500.000,00

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e



1

parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("ALL").

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.


Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmeritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

- Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

- Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerësohet mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje



2

të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

- Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

3.Politikat e Parimet kontabël më domethënëse të pëdorura nga shoqëria, janë si më poshtë:

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.



Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

Aktivitet dhe detyrimet financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit(duke përfshirë edhe çmimin e trasaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë



ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara në pikën 7 dhe 8 të SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktiviteti financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shumat për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.


Nëse, në një periudhë pasuese, shumat e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivitetet dhe detyrimet financiarë shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në përcaktimet e SKK-2.

Të drejta të arkëtueshme

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogaritë të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e të drejtave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Handwritten signature



Handwritten signature 4

Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëhere kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur. Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.


Aktivitet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiviteti kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të hyrë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor

Ragmi



5
[Signature]

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesine mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 %, në pajisje informatike 25% dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.


Aktivitet afatgjata jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri dhe aktiviteti nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiviteti jomaterial bëhet me kosto, ndërsa vlerësimi i mëpashtëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merret parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund



të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shumat e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëllti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëllti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë fatuar apo paguar.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare


Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Fondet për pension

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

Rogani



[Signature]

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojne kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin.

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë **1 euro=123.71leke, 1 dollar= 100.84 leke, 1 Franga Zvicerane= 114.46 leke dhe 1 pound = 137.93 leke**

Tatimin mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.



Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 është 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjore apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Detyrimet Afatshkurtra e Afatgjata

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqëris. Ato aplikohen retrospektivisht.

4. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)



Gjendjet e mjeteve monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute janesi meposhte :

	Viti 2020	Viti 2019
Gjendja e bankes -	35,692,267	106,586,396

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.

5 Investime

Investimet, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon: jane zero



6. Të drejta të arkëtueshme afatshkurtra

Të drejtat e arkëtueshme, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020-- jane zero

7. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten si vijon:

	Viti 2020	Viti 2019
- Mallra -----	17,192,459	0
- Parapagime per inventar -	1,170,029	0
- Totali -----	18,362,488	0

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2020. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kosos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar", gjeneruar nga programi "Financa 5".

8. Shpenzime të Shtyra

Jane evidentuar shpenzimet e kryera per rikonstruksionin e ambienteve ekzistuese te laboratoreve te spitaleve sipas kontrates me Ministrine e Shendetise dhe qe do te shperndahen ne disa periudha.


9. Aktivet afatgjata materiale impianti dhe makineri vetem ne vitin 2020


-a Impiante dhe makineri me vlere --	187,937,698 leke
-b Te tjera instalime dhe pajisje me vlere--	55,297,888 leke, nga keto jane:
- Motociklete -----	115,000
- Mobilje dhe pajisje zyre ----	22,172,125
- Pajisje informatike -----	33,010,763

DETYRIMET

10. Detyrime Afatshkurtëra

a. "Titujt e huamarrjes " paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj huadhenesve te ndryshem ne fund te ushtrimit



10


b. "Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit" ne shumen 116,685,162 leke paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj Furnitoreve te ndryshem ne fund te ushtrimit.

c. "Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet." ne shumen 1,346,123 leke paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj punonjesve dhe Sigurimeve Shoqerore e Shendetesore te muajit dhjetor 2020.

d. "Të Pagueshme për Detyrime Tatimore " ne shumen 404,648 leke perbehet nga detyrimi per:

- tatim mbi te ardhurat personale muajit dhjetor 2020. me vlere— 385,173 leke
- tatimi ne burim per muajin dhjetor 2020 me vlere----- 19,691 leke
- dhe parapagim detyrim doganor ----- (216) leke

	Viti 2020	Viti 2019
- Huamarje -----	0	170,478,000
- Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit --	116,685,162	226,346
- Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sig shoq shend	1,346,123	353,761
- Te pagueshme per detyrime tatimore	404,648	45,165

11.Detyrimet afatgjata

	Viti 2020	Viti 2019
- Titujt e huamarjes -----	86,590,000	0
- Detyrimet ndaj institucioneve te kredise ne banke -----	277,027,715	0

12 Kapitali dhe rezervat

a.Kapitali i nenshkruar :

Kapitali rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, është 10,000,000 ALL dhe zoterohet nga :

1. LABOPHARMA SHPK Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 41.7% të pjesëve të

Kapitalit - Para: 4.170.000,00 leke.

2. AB Laboratory Solutions B.V Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 33.3% të pjesëve të


Kapitalit - Para: 3.330.000,00 leke.

3. EXALAB Ortak i shoqërisë zotërues i 1 kuote me 25% të pjesëve të

Kapitalit - Para: 2.500.000,00

	Viti 2020	Viti 2019
-Kapitali i nenshkruar	10,000,000	10,000,000
-Humbja e pashperndare e vitit 2019	(748,232)	0
-Humbja e periudhes	(65.678.188)	(748.232)
Totali i kapitalit	(56,426,420)	99,251,768







LABORATORY NETWORKS shpk
Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

▪ **Te Ardhurat**

Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

	Viti 2020	Viti 2019
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	30,670,190	0

▪ **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

	Viti 2020	Viti 2019
> Kosto e mallrave te shitura	51,689,856	0
> Kosto e Punes	15,341,334	1,241,375
> Amortizimi	6,003,716	0
> Qira	851,974	29,500
> Sigurime	584,253	0
> Shpenzime te tjera	508,075	0
> Shpenzime noteriale	130,960	7,160
> Shpenzime instalim energjie	404,745	0
> Shpenzime per mirembajtje IT	206,000	0
> Shpenzime per personelin , etj	82,500	0
> Shpenzime importi e sherbime nga jashte vendit	6,680,130	0
> Transferime,udhetime,dieta	102,212	0
> Shpenzime postare e telefon	325,774	0
> Shpenzime Transporte per bleje	4,292	0
> Sherbime bankare	2,144,736	63,718
> Taksa dhe tarifa vendore	84,574	33,500
> Shpenzime per pritje e perfaqsim	171,875	2,100
> Gjoha dhe demshperblime	34,960	40,065
> Shpenzime IPC te bera ne vitin 2019 qe shkarkohet per 10 vjet	7,642,644	
Totali shpenzime	92,994,610	1,417,418
Te ardhura nga shitja	30,670,190	
Humbje	(62,324,420)	


Humbja nga aktiviteti i shfrytezimit është 62,324,420 Leke.

▪ **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

Analitikisht jane si me poshte :

[Signature]



12
[Signature]

LABORATORY NETWORKS shpk
Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
Te ardhura nga interesat	0	3074
Fitim nga kembimet valutore	922,929	666,112
Shpenzime per interesa	(4,276,697)	0
Humbje nga kembimet valutore		0
Shuma	(4,952,32)	669,186

1. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2020 jane si vijon:

Te ardhura dhe shpenzime	Te ushtrimit	Tatimore
8/9 Te ardhurat	8	31,593,119
10/11 Shpenzimet	10	97,271,307
12 Shpenzimet e pazbritshme - Gjoha		0
Rezultati		
13/14 Humbje	13	-65,678,188
		-65,563,364

2. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të Pasqyrave Financiare.

3. Transaksione te paleve te lidhura e shpjegime mbi palët e lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marrredhenie te mundshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, ne 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

4. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2,(të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2019 janë riparaqitur sipas këtyre zërave.

HARTUESI

Adriana Zagovic



ADMINISTRATORI

SOKOL RAMIZI

